

| Pozita | Ligjërues |
|--------------------|---------------------------------------|
| Nr. i referencës | IKAF-01 |
| Lloji i Kontratës | Kontratë shërbimi |
| Raporton | Drejtorit Ekzekutiv |
| Departamenti | Departamenti për Zhvillim Profesional |
| Forma e angazhimit | Honorar |
| Nr. i pozitive | 4 |
| Vendi: | Prishtinë |

Instituti KAF është i përkushtuar në ndërtimin e profesionit të kontabilistëve dhe auditorëve në bazë të parimeve të larta Profesionale Etike, Standardeve Ndërkombëtare, sipas Rregulloreve të Ligjit në fuqi dhe sipas planprogramit të harmonizuar me ACCA dhe IIA Global, me literaturë të përshtatshme praktike të cilën ligjëruesit duhet ta sjellin dhe prezantojnë para kandidatëve duke dëshmuar shkathtësi dhe aftësi profesionale për transmetimin e dijes dhe shtjellimin me kujdes të rasteve studimore.

Ligjëruesi në Institutin KAF ka për detyrë të trajnon teorikisht dhe praktikisht situatat e reja të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, duke futur frymën e standarteve në harmonizim me rregullat në vendin tone dhe me ato të Bashkimit Europian.

Kushtet e nevojshme:

Për titullin **Ligjërues**, kandidati duhet të dëshmojë dokumentacionin si më poshtë:

1. Dëshmon kualifikimin akademik dhe profesional
2. Dëshmon nivel të lartë dhe kompetencë profesionale që dëshmohet me:
 - a) Një numër të rëndësishëm të punimeve dhe aktiviteteve profesionale;
 - b) Pjesëmarrje aktive në seminare, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - c) Të ketë eksperiencë në ligjërime
 - d) Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;
 - e) Aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme;
 - f) Aftësi për udhëheqje akademike/profesionale;
 - g) Njohuri të theksuar të SNK/SNRF/SNA ose Standardet Profesionale të Auditimit të Brendshëm.